

Jetojmë kështu...

*Një eksperiencë
veçanërisht të
fortë.*

JEAN - Europa

Ishim 14 djem europianë në Republikën Domenikane. Për tre javë kemi punuar në një shkollë, me një nga projektet e të dhuruarit, dhe si djem për unitet kemi punuar për ta çuar përpara, për më tepër se 10 vjet!

Me djemtë kemi lyer pesë klasa shkollore, kemi sistemuar fushën sportive, kemi mësuar 200 fëmijët që ishin prezentë. Kjo eksperiencë ka qenë veçanërisht e fortë për mua!

Ndieja një gëzim të madh që më në fund mund të bëja diçka konkrete për ta bërë më të mirë botën. Kam parë, me qenë se ishim në një shtet të varfër, gëzimin e pamasë të Domenikanëve. Kam përshtypjen se kam marrë më shumë nga çfarë kam dhënë, mbi të gjitha në shkollë me fëmijët. Kemi punuar me shpirt...e si "profesorë".

Shihja gëzimin e fëmijëve dhe ishim të gëzuar. Kemi eksperimentuar shumë fort dashurinë reciproke mes nesh.

Nuk ishim profesorë apo vizitorë për ta, por miq e vellezër të mëdhenj. Edhe ata do të mbeten për ne motrat e vellezërit tanë të vegjël.

PAROLA DI VITA | 10

«Nëse e doni njëri-tjetrin, të gjithë do të shohin se jeni nxënësit e mi!»

(Gjn 13, 35)

Një nga shkrimet e krishtera më magjepsëse të shekujve më përpara, thotë se; "të krishterët nuk dallojnë nga të tjerët në bazë të territorit, të mënyrës si flasin, e as për mënyrën e të veshurit. E në fakt nuk jetojnë as në qytete të veçanta, nuk përdorin ndonjë fjalor të çuditshëm, a nuk adhurojnë ndonjë mënyrë të veçantë të jetuari." Janë persona normalë, si ti e si të tjerët.

E ndoshta zotërojnë një sekret që i lejon ato të veprojnë thellë në shoqëri, duke u shndërruar në shpirt. Konsiston në dashurinë ndaj njëri-tjetrit.

Është ky vullneti i fundit i Jezusit, testamenti i tij, jeta e qiellit që e ka sjellë në tokë, që e ndan me ne, që të bëhet vetë jeta jonë. Do që dishepujt e tij të dallohen për dashurinë reciproke!

Dëshmia që Jezusi e rikërkon është për atë që të gjithë të jenë një komunitet që demonstroi dhe shpall që ungjilli është i vërtetë. Ai duhet të bëjë të shohë që jeta e tij na gjeneron një shoqëri të re, në të cilën jetojnë raporte autentike vëllazërore, raporte të ndihmës e shërbimit ndaj personave në nevojë.

A nuk bënin kështu të krishterët e parë në kohën e romakëve?

Jemi ne sot, "të krishterët e parë", të thirrur, si ata, të falur, të rinj, duke ndihmuar, me një fjalë, duke dashur me të njëjtin intensitet si Jezusi ka bërë, me qartësinë që prezenca e tij në mesin tonë ka forcën të përfshijë edhe të tjerë në dijen hyjnore të dashurisë.

“Shfrytëzoj çdo rast për të bërë një shërbim ndaj të tjerëve që të rritet dashuria reciproke në komunitetin tim”



IMPENJOHEM:

TË RRIS DASHURINË

RECIPROKE NË

KOMUNITETIN TIM